



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1986/L Prot.

Vlorë, më 22.12. 2021

VENDIM
Nr. 38, datë 20.12.2021

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, PËR VITIN AKADEMIK 2020- 2021

Mbështetur në nenin 32, nenin 49 pika 1, shkronja h, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 25, pika 1, shkronja h, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.24, datë 21.10.2019 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatet për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", si dhe Vendimit të Rektoratit nr.34, datë 13.12.2021, Bordi i Administrimit në mbledhjen e përbashkët me Senatin Akademik të datës 20.12.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin vjetor të veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin akademik 2020-2021, hartuar nga Rektorati dhe miratuar me vendim nr. 34, datë 13.12.2021.
2. Bashkëlidhur një kopje e Raportit vjetor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Ervis MOCKA

